

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, prokuroria i komunikon akuzën autorit Elvis Shkambi
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/26/mbyllen-hetimet-per-vrasjen-e-gjyqtarit-astrit-kalaja-prokuroria-i-komunikon-akuzen-autorit-elvis-shkambi/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 18:20:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 18:19:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	614129954b67aed022cc190bb494c468fade65fa12168afaf4775a6ff464c896
TEKSTI	54d8da6e3851f995c6c179986f7e3fa189aeb6f3987e2768df8f57762ed09c68
PAMJA	6d620fffa4a4a04500007a2530b6523310770e0e968e709df8be34982b26169

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	43f3a18ebf06c5404d0f0ce9076142f76c7fd524811fad66bea2483e2de65098
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f1d82a646bd703b2c3db300ad07fe31d63113d7410715c948367b3c04c7e5621
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/43f3a18ebf06c5404d0f0ce9076142f76c7fd524811fad66bea2483e2de65098>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, prokuroria i komunikon akuzën autorit Elvis Shkambi

20:19 : 26/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE



Prokuroria e Tiranës i ka komunikuar sot Elvis Shkambit akuzën për “vrasje të funksionarëve publikë për shkak të detyrës”, në kuadër të hetimeve për vrasjen e gjyqtarit të Apelit, Astrit Kalaja.

Gazetarja e Top Channel, Anila Hoxha, bën me dije se mbyllja e hetimeve për ngjarjen i është komunikuar sot Shkambit, i cili ndodhet në masën e sigurisë “arrest në burg”.

Ndërkohë, sipas të njëjtave burime, Gjon Shkambit, xhaxhait të Elvis Shkambit, akuza do t'i komunikohet ditën e hënë. Elvis Shkambi përballet gjithashtu me akuzën për “vrasje në rrethana cilësuese” të mbetur në tentativë, lidhur me plagosjen e dy personave, babë e bir, që ishin palë kundërshtare në procesin gjyqësor.

Në fazat e mëparshme të procedimit, ndaj tij është hetuar edhe akuza për armëmbajtje pa leje. Sa i përket Gjon Shkambit, ai ka deklaruar se nuk kishte dijeni për planet e nipit të tij dhe se nuk ka pasur dijeni se Elvsi do të ndërmerre një veprim të tillë.

Ky qëndrim është bërë i ditur edhe më herët nga mbrojtja e tij, ndërsa Prokuroria ka ngritur dyshime për rolin e tij në ngjarje.

Lexo edhe:[Vrasja e Astrit Kalasë në sallën e gjyqit, zgjaten me tre muaj hetimet](#)[U vra në sallën e gjyqit/ Shoqata e Gjyqtarëve kërkon që Astrit Kalaja të shpallet “Dëshmor i Atdheut”](#)

Si ndodhi ngjarja

Ngjarja e rëndë ndodhi më 6 tetor 2025, rreth orës 15:40, në ambientet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë.

Gjatë një seance gjyqësore, Elvis Shkambi qëlloi me armë zjarri drejt gjyqtarit Astrit Kalaja, si dhe drejt dy personave të tjerë, babë e bir, Ragip dhe Ervis Kurtaj, të cilët ishin palë në proces. Kalaja humbi jetën, ndërsa dy personat e tjerë mbetën të plagosur.

TË GJITHA



Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, prokuroria i komunikon akuzën autorit Elvis Shkambi

20:19 : 26/09/2026



"Vlora Hyseni ka tentuar të përçajë protestën"/ Aktivisti thirrje qytetarëve: Dilni në shesh të rrëzojmë Ramën

20:11 : 26/09/2026



A po përgatitet Britania për një rikthim në Bashkimin European?

20:06 : 26/09/2026



"Ramës i duket vetja pronar i Shqipërisë"/ Qytetarja: Ne me 120 mijë lekë pension, këta shtrihen në hotele luksoze

19:57 : 26/09/2026



"Kërkojmë konfiskimin e pasurive të Ramës"/ Aktivistja: Ktheu shtetin në organizatë kriminale!

19:48 : 26/09/2026



Trajneri Maran zgjedh 11-shen titullare kundër Bjellorusisë, rikthime dhe surpriza te Shqipëria

19:42 : 26/09/2026



Rama apo shqiptarët, kush do të rezistojë më gjatë?

19:26 : 26/09/2026

Sipas hetimeve të bëra publike nga Prokuroria, të shtënat ndodhën pasi gjyqtari Kalaja kishte lexuar vendimin në një çështje pronësie ku palë ishin familja Shkambi dhe familja Kurtaj.

Prokuroria ka deklaruar gjithashtu se po hetonte rolin që mund të kishte pasur Gjon Shkambi në nxitjen e veprimeve ndaj palës kundërshtare.

Etiketa: Astrit Kalaja Elvis Shkambi

Lajme të lidhura



Vrasja e Astrit Kalasë në sallën e gjyqit, zgjaten me tre muaj hetimet

14:25 : 16/07/2026



U vra në sallën e gjyqit/ Shoqata e Gjyqtarëve kërkon që Astrit Kalaja të shpallet "Dëshmor i Atdheut"

12:39 : 08/07/2026



Vrasja e gjyqtarit Astrit Kalaja/ Hetimi "peng" i aktekspertimit të celularit të Elvis Shkambit

13:48 : 27/06/2026



Vrasja e gjyqtarit Kalaja, Apeli refuzon zëvendësimin e masës së sigurisë për Gjon Shkambin

20:29 : 26/04/2026



Zgjatet hetimi për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, Prokuroria kërkon edhe 3 muaj kohë

15:55 : 04/04/2026



U vra në Gjykatën e Apelit, familja e Astrit Kalasë kërkon të shpallet "Dëshmor i Atdheut"

20:11 : 08/03/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

